



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE
KRYESIA

Prot. 766

Tiranë, më 13.12.2021

Vendim nr. 69 datë 13.12.2021

Për krijimin e njësisë kërkimore-studimore për arbëreshët, arvanitët dhe arbëneshët (më tej: NJKS-AAA)

Referuar neneve 4 pika 6 dhe 19 pikat 1 dhe 3 të Ligjit 53/2019 Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë; si dhe neneve 44 e 46 të Statutit të saj; mbështetur në rezultatin e votimit të anëtarëve të Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike - SSHSHA (bashkëngjitur), shkresën e komisionit të arkeologjisë e historisë dhe komisionit të gjuhësisë dhe studimeve letrare (bashkëngjitur); si dhe në dokumentin përkatës paraqitur nga propozuesit akad. Francesco Altimari e akad. Matteo Mandalà (bashkëngjitur); Kryesia e Akademisë së Shkencave, në mbledhjen e datës 13.12.2021:

Vendosi:

1. Ngrihet *njësia kërkimore-studimore për arbëreshët, arvanitët dhe arbëneshët* (më tej me shkurtesën NJKS-AAA), me qëllim përqendrimin e dijes dhe rritjen e cilësisë e të profesionalizmit në këtë fushë veprimi të albanologjisë, si dhe forcimin e perspektivës së tyre, nëpërmjet ndërmarrjes dhe realizimit të projekteve dhe studimeve të veçanta.

NJKS-AAA ka për detyrë të krijojë ndërveprim të suksesshëm shkencor brenda bashkësisë së studiuesve të botës arbëreshe-arvanite-arbëneshë

për të mundësuar thellimin e kërkimeve dhe studimeve për trashëgimitë materiale e shpirtërore, historike e kulturore, gjuhësore e letrare, të tri bashkësive objekt kërkimi për të, me përparësi ndjekjen e katër projekteve madhore: a). Botimi i *Opera omnia* të Fr. A. Santorit; b). Miratimi i projektit afatgjatë të botimit të klasikëve të letërsisë arbëreshe prej fillimeve deri në shekullin XX; c). Implementimi progresiv i fjalorit digjital të arbërishtes letrare dhe dialektore, hartuar nga Fondacioni Universitar “Francesco Solano”, si dhe hartimi dhe botimi i fjalorit të arbërishtes së shkruar dhe të folur, pasi të përfundohet implementimi i tij digjital; ç). Hartimi dhe botimi i një fjalori të të folmeve arvanite, në bazë të leksikut të kërkimeve gjuhësore të akad. Titos Jochalas (në Eubea, Andros, Idhra, Morea), duke përfshirë të folmet që tani janë pothuajse gati (Atika dhe Beotia).

2. NJKS-AAA përbëhet nga anëtarët e jashtëm të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë Francesco Altimari, Matteo Mandalà e Elton Prifti dhe nga anëtarët e nderit Leonardo Maria Savoia dhe Titos Jochalas. Drejtues i NJKS-AAA është prof. Francesco Altimari. Koordinatorë të saj janë prof. Matteo Mandalà e prof. dr. Shaban Sinani.

3. NJKS-AAA krijon rrethin e bashkëpunëtorëve të saj. Evidentimi i individëve dhe grupeve të kërkuesve shkencorë cilësorë në vendet ku gjenden bashkësitë historike-kulturore - objekt i kërkimeve e studimeve të saj; në Shqipëri, Kosovë e në Maqedoninë e Veriut; si dhe nga radhët e albanologëve të huaj, që mund të ofrohen për bashkëpunim, duke finalizuar fazën e parë të anëtarësimit, përfundon deri më 31 mars 2021.

4. Deri në mesin e vitit 2022 NJKS-AAA të paraqesë propozimet e saj për nisjen e zbatimit gradual të projekteve të parashikuara në pikën e parë.

5. NJKS-AAA kontribuon me anëtarët dhe bashkëpunëtorët e saj për realizimin e tre projekteve madhore në albanologji.

5. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohen: kryetarët e komisioneve përkatëse, kryetari i Seksionit të Shkencave Shoqërore e Albanologjike, sekretari shkencor i Akademisë së Shkencave, kancelari dhe drejtuesi i NJKS-AAA.

6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Akademik Skënder GJINUSHI

KRYETAR

2

